



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.15 Regj.Them.
Dt. Regj. 20.04.2023

Nr. 13 Vendimi
Dt. Vendimi 21.04.2023

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Marsela DERVISHI** (*Relarore*)
Gjyqtare: **Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Emona MUÇI** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Esmeralda XHILI** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)

me sekretar gjyqësore **Francesk Aliaj**, sot më datë 21.04.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. 15 Akti, datë 20.04.2023 që i përket:

PADITËS: **Koalicioni ‘BASHKË FITOJMË’**, përfaqësuar nga Partia Udhëheqëse e Koalicionit “Partia e Lirisë”, përfaqësuar në gjykim nga Av. Altin Kaziaj dhe Av. Franci Nuri, pajisur me Autorizim nr. 146/1 prot., datë 18.04.2023.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar nga znj. Ina Osmanaj dhe z. Erdal Mema, pajisur me Autorizim nr. 4052 prot., datë 21.04.2023.

PERSON I INTERESUAR: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, me seli në Tiranë, Rr. “Donika Kastrioti”, nr. 3, përfaqësuar nga Av. Indrit Sefa, pajisur me Autorizim datë 22.03.2023.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

Ndryshimin e vendimeve nr. 361 dhe 362 të KSH, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, si dhe për 60-bashkitë e tjera në vend, duke vendosur përbri emrit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” emrin e z. Sali Berisha.

BAZA LIGJORE:

Neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së; nenet 4, pika 1, 9, 45, 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë; nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor të RSH, (i ndryshuar).

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

Pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjo pretendimet e fundit të palëve, ku:

Pala paditëse, Koalicioni “BASHKË FITOJMË” kërkoi:

- Pranimin e padisë sipas objektit;

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi:

- Rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 50, datë 17.04.2023, të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve;

Personi i interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë kërkoi:

- Rrëzimin e kërkesë padisë.

VËREN:

1. Se pala paditëse, Koalicioni “BASHKË FITOJMË” i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Ndryshimin e Vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur: Ndryshimin e vendimeve nr. 361 dhe 362 të KSH, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, si dhe për 60-bashkitë e tjera në vend, duke vendosur përbri emrit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” emrin e z. Sali Berisha*”.

2. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

3. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 153 pika 1 (c) dhe 154 pika 3 (c) të Kodit Zgjedhor, si dhe nenin 193 të K.Pr.Civile, duke vlerësuar faktin se subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, ka qënë palë pjesëmarrëse në procedurën administrative, i ka

njoftuar kësaj të fundit kopje të kërkesëpadisë dhe akteve, duke e thirrur në proces si palë e interesuar.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

4. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Pala paditëse, koalicioni “BASHKË FITOJMË”¹ është subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

5. Personi i interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë² është parti politike e regjistruar si subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 361, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, ka vendosur:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

7. Gjithashtu, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 362, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, ka vendosur:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak, në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

8. Në këto vendime, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndër të tjera ka arsyetuar:
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afateve të përcaktuara në nenin 67, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka regjistruar

¹ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur: *1.Regjistrimin e Koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PDK-PBDNJ), “BF”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:a) “Partia e Lirisë” (PL);b) “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDK);c) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).*

² Me vendimin nr. 179, datë 18.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, “Për regjistrimin e “Partisë Semokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ka vendosur: *Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me shkronja nistore “PDSH”, me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*

për të marrë pjesë në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të regjistruara më parë si subjekte zgjedhore.

Me vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, Komisioni Rregullator "Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", të ndryshuar, ka përcaktuar procedurën për hedhjen e shortit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbledhjen e datës 13.4.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator dhe në përfundim të zhvillimit të shortit, u përcaktua renditja që do të kenë subjektet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Rënditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për subjektet zgjedhore të cilat kanë depozituar lista shumemërore

9. Kundër këtyre vendimeve të mësipërme, personi i interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur kërkesë ankimore nr. 50, më datë 17.04.2023 (sipas protokollimit pranë KQZ me nr. 3881 prot., datë 17.04.2023) në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt: "Shfuqizimi i vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për "Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023". Shfuqizimi i vendimit nr. 362, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për "Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023". Ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit duke vendosur të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 98 pika 3 e kodit zgjedhor sipas propozimit bashkëlidhur", duke parashtruar ndër të tjera se:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka anashkaluar kërkesat e bëra në seancën publike të datës 15.04.2023.
- Në referim të përmbajtjes së nenit 98 të Kodit Zgjedhor, kjo vendimarrje krijon konfuzion të madh të zgjedhësit duke mos e qartësuar faktin se kush subjekte garojnë nën siglën e një koalicioni, kush është partia drejtuese e saj dhe rrjedhimisht, kush është kryetari i partisë që drejton këtë koalicion. Më konkretisht Koalicioni 'Bashkë Fitojmë' me shkronja nistore BF drejtohet nga Partia e Lirisë me kryetar Ilir Metaj dhe kjo e përcaktuar qartësisht në marrëveshjen e koalicionit të datës 15.03.2023.
- Në pikën 3 të kësaj Marrëveshje Koalicioni është përcaktuar qartësisht se partia udhëheqëse e këtij koalicioni është Partia e Lirisë si dhe në pikën 4 të kësaj marrëveshje, përcaktohet qartësisht që i autorizuari i këtij koalicioni është z. Ilir Metaj, kryetar i Partisë së Lirisë. Përsëri në pikën 3 të kësaj marrëveshje është përcaktuar qartësisht dhe fakti që logo e koalicionit do të jetë ajo e referuar në këtë marrëveshje. Siç shihet gjatë aktiviteteve elektorale të zhvilluara nga ky subjekt zgjedhor dhe të kandidatëve të propozuar nga ky i fundit, janë përdorur logo dhe emri i subjektit zgjedhor Partia Demokratike në kundërshtim flagrant me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

- KSHZ me anë të vendimarrjeve të tij për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit të Kandidatëve për Anëtar të Këshillat Bashkiak, nuk i ka dhënë zgjidhje kësaj problematike duke lejuar dhe duke shtuar më shumë paqartësinë e zgjedhësve për identifikimin e qartë të alternativës që do të votojnë dhe duke i krijuar konfuzion zgjedhësve për të identifikuar qartësisht partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni dhe partinë drejtuese të tij. Kjo vendimarrje përveçse është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, ajo gjithashtu nuk ka respektuar vendimarrjet e mëparshme të KAS dhe Kolegjit Zgjedhor.
- Propozimi i Partisë Demokratike është që në Fletën e Votimit të vendoset emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit dhe gjithashtu dhe shkronjat nistore të subjekteve pjesëmarrëse në të.
- Për sa kohë që për të gjitha subjektet e tjera është e domosdoshme përcaktimi dhe vendosja e emrit të Kryetarit të Partisë në Fletën e Votimit, e njëjta dispozitë do të duhet të zbatohet dhe për koalicionet zgjedhore, pasi në referim të nenit 65 pika 3 referohet qartësisht që të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor do të duhet të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit, që në këtë rast është Partia e Lirisë dhe Partia Balli Kombëtar Demokrat.

10. Në seancë e zhvilluar nga KAS, mori pjesë si palë interesuar pala paditëse koalicioni “Bashkë Fitojmë”, i cili parashtroi ndër të tjera se:

- Në rastin konkret nuk ka vend për konfuzion të zgjedhësit, për sa kohë koalicioni “Bashkë Fitojmë” nuk ka emblemë të ngjashme me “Partinë Demokratike të Shqipërisë”.
- Pajisja me një emër ose jo në fletën e votimit nuk përbën disvantazh, pasi është vetë koalicioni, me anë të marrëveshjes që vendos, se cilin emër propozon si drejtues të tij. Me shkresën nr. 367 prot., datë 19.04.2023 të depozituar nga z. Endrit Braimllari, paraqitën vullnetin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të vendosur emrin e deputetit z. Sali Berisha për bri emrit të koalicionit, si deputet i pavarur në raport më të gjitha partitë përbërëse të koalicionit.

11. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi mori në shqyrtim kërkesën ankimore nr. 50, më datë 17.04.2023, **me vendimin Nr. 61, datë 19.04.2023** ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, sa i takon pasqyrimin të emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve “Bashkë Fitojmë” dhe “Aleanca Liberale e Djathtë”, në fletën e votimit.
2. Rrëzimin e kërkesës së “Partisë Demokratike të Shqipërisë” për sa i përket pasqyrimin të shkronjave nistore të partive përbërëse të koalicioneve për bri emrit të koalicionit përkatës.
3. Rrëzimin e kërkesës së palës së interesuar, koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për vendosjen e emrit të deputetit z. Sali Berisha në fletën e votimit si drejtues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

12. Në këtë vendim, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:

1. Vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023 kanë miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë dhe për këshillat bashkiakë të 60 bashkive të tjera, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Vendimet nuk përmbajnë arsyetimin pse nuk është marrë në konsideratë kërkesa e ankuesit që përbri emrit të koalicioneve të shënohet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit përkatës, por nga rileximi i debatit të seancës publike rezultoi se Komisioneri ka gjykuar se për koalicionet duhet lënë në diskrecionin e vetë këtyre subjekteve, nëse duan t'a pasqyrojnë emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të përfshirë në fletën e votimit apo jo.

2. Si organ publik, Komisioneri është i pajisur me pushtet diskrecial. Sipas Kodit të Procedurave Administrative, "diskrecioni i organit publik" është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik (pika 3 e nenit 3 të K.Pr.Administrative).

4. ...Kolegji Zgjedhor, në vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, pasi ka konfirmuar të drejtën e Komisionerit për diskrecion në kompozimin e fletës së votimit, ka njohur faktin se "organet e ankimit duhet të respektojnë diskrecionin e Komisionerit, sa kohë që nuk provohet qartazi se zgjedhja e Komisionerit është në kundërshtim me ligjin dhe dëmton rëndë procesin zgjedhor".

5. Ky kontekst kërkon që shqyrtimi i ankimit nga KAS-i të jetë strikt shqyrtim ligjshmërie. KAS-i duhet të shqyrtojë dhe të vendosë nëse vendimi i Komisionerit për t'a lënë në zgjedhje të përfaqësuesve të koalicioneve vendimin për të pasqyruar ose jo në fletën e votimit emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit është brenda të drejtës së tij për diskrecion, apo jo, sikurse duhet të verifikojë, nëse diferencimi në fletën e votimit i koalicioneve nga subjektet e tjera është brenda kompetencës së Komisionerit, apo jo.

...Nga analiza ligjore e çështjes (shih vendimin e KAS-it nr. 19, datë 03.04.2021) KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me:

...• emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3);

7. ...Diskrecioni është metodë e ushtrimit të autoritetit publik, metodë vendimmarrjeje. Diskrecioni nuk delegohet tek palët, sepse vendimmarrja nuk delegohet tek palët. Nëse vendosja e emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit është çështje e diskrecionit të Komisionerit, atëherë vendimin për këtë duhet t'a marrë Komisioneri, kurrsesi përfaqësuesi i koalicionit zgjedhor pjesëmarrës në garë. Ky delegim kompetence është i paligjshëm. Vendimmarrja që pranon këtë delegim është e paligjshme.

8. ...Objektivi në kompozimin e fletës së votimit është që të hartohet një fletë votimi që e bën sa më të qartë ofertën dhe alternativat konkurruese, që shmang mundësitë e konfondimit të

zgjedhësve dhe që e bën sa më të thjeshtë votimin dhe sa më të kuptueshëm vullnetin e zgjedhësve. KAS-i është shprehur edhe në vendimin e tij nr. 19, datë 03.04.2021 se “sa i përket kompozimit të fletës së votimit, interesi i zgjedhësve është interes madhor në raport me interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votimit nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve ... Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë ... Për këtë arsye, KQZ-ja nuk mund të vendosë si objektiv konsensusin publik apo midis subjekteve zgjedhore kur kompozon fletën e votimit, por duhet të kujdeset që të plotësojë pa kompromis nevojat e votuesve për fletë votimi të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim”.

9. Koalicionet zgjedhore janë krijesa politike, në përgjithësi, jetëshkurtra. Ato janë aleanca politike që farkëtohen në harkun e një procesi zgjedhor dhe që, si rregull, shpërbëhen pas zgjedhjeve. Këtu e ka burimin interesi i fortë elektoral për përdorimin tek koalicionet të të gjithë gamës së instrumenteve identifikues, më shumë se për partitë politike tradicionale, të cilat njihen dhe identifikohen lehtësisht edhe vetëm nga logoja, shkronjat nistore apo emri i kryetarit. Duke përdorur gjithë gamën e instrumenteve identifikues për koalicionet, rritet besimi dhe siguria se zgjedhësit do ta kenë më të lehtë t'a dallojnë dhe identifikojnë koalicionin në morinë e subjekteve garuese. Interesi i përfaqësuesve të palës së interesuar për të shmangur emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit “Bashkë Fitojmë” nga përfshirja në fletën e votimit nuk shpjegohet me nevojën dhe interesin e zgjedhësve për transparencë e qartësi. Një instrument identifikues më pak, do të thotë më pak qartësi për zgjedhësit.

10. Me vendimmarrjen e tij, Komisioneri e ka trajtuar çështjen e vendosjes ose jo të emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit në fletën e votimit si çështje që i përket vetëm interesave të koalicionit përkatës dhe, me këtë, i është kundërvënë objektivave të vendimmarrjes institucionale. Komisioneri duhet të kishte arsyetuar nëse i bën mirë apo keq zgjedhësve përfshirja e emrit të kryetarit të partisë (ose të partisë udhëheqëse) në fletën e votimit, ose, më saktë, të shpjegonte pse, në çmimin e tij, pasqyrimi në fletën e votimit i emrit të kryetarit të partisë u bën mirë zgjedhësve, kurse pasqyrimi i emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit u bën keq atyre.

11. Lidhur me kushtin që zgjedhja të mos përbëjë shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme, KAS-i pranon arsyetimin dhe provat e paraqitura nga ankuesi lidhur me praktikën e zgjedhjeve të vitit 2021. KAS-i çmon se devijimi nga vendimmarrja e mëparshme përbën shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga Komisioneri në zgjedhjet e vitit 2021.

12. ...Pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor përcakton se “emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi”. Fjalja e dytë është e vlefshme si për partitë politike që garojnë më vete, ashtu dhe për koalicionet zgjedhore. Në vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e ka sqaruar në mënyrë ezauruese këtë dileme, kur në pikën 27 të vendimit ka theksuar se “Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike

udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore”.

13. Arsyetimi konfirmohet edhe nga analiza në të kundërt e dispozitës. Nëse Komisioneri çmon se kjo fjali vlen vetëm për partitë që garojnë më vete në zgjedhje, atëherë përbri emrit të koalicionit nuk mund të qëndrojnë as sigla dhe as shkronjat nistore, as të partive pjesëmarrëse, as të koalicionit. Nëse në fletën e votimit të miratuar nga Komisioneri është përcaktuar se përbri emrit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” duhet të vendoset sigla dhe shkronjat nistore, atëherë emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit duhet të vendoset, gjithashtu. Ky është përcaktim ligjor, i cili nuk lë hapësirë për diskrecion. Fjalitë e dytë e pikës 3 të nenit 98 (Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë) nuk mund të copëtohet dhe prej saj të përzgjidhet dhe të vendoset në fletën e votimit përbri emrit të një koalicioni, sipas rastit, vetëm sigla, vetëm shkronjat nistore apo vetëm emri i kryetarit të partisë udhëheqëse. ...

15. Pala e interesuar, subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, paraqiti në seancë kërkesën që përbri koalicionit, në fletën e votimit, të pasqyrohet emri i deputetit Sali Berisha, si drejtues i koalicionit. Pala e interesuar deklaroi në seancë vullnetin për të pasur të shënuar në fletën e votimit “drejtuesin e koalicionit”, në pajtim me kërkesën e ankuesit, por insistoi se drejtuesi i koalicionit mund të caktohet vetëm nga partitë pjesëmarrëse të tij me vullnetin e tyre të lirë dhe nuk duhet të jetë domosdoshmërisht kryetari i partisë udhëheqëse të tij.

16. Shkresa e paraqitur në seancë nga përfaqësuesit e palës së interesuar me nr. 367 Prot., datë 19.04.2023 dhe që është nënshkruar në emër të koalicionit nga përfaqësuesi Endrit Brahimllari, pavarësisht se u prezantua si shprehje e vullnetit të partive pjesëmarrëse të koalicionit, nuk ka vlerën e një marrëveshjeje amenduese të marrëveshjes bazë të datës 15.03.2023, që të mund të merret në konsideratë nga KQZ-ja, në kuptimin e nenit 65 të Kodit Zgjedhor. Por edhe sikur të ishte e tillë, ajo nuk mund të sillte asnjë ndikim në çështjen në shqyrtim nga KAS-i, pa kaluar më parë në procedurë regjistrimi dhe amendimi të vendimit të Komisionerit nr. 178, datë 18.03.2023 (nëse lejohet nga ligji). Në trajtimin e çështjes, KAS-i nuk u bazua tek shkresa nr. 367 prot., datë 19.04.2023, por në kërkesën e formalizuar nga përfaqësuesit në seancë të palës së interesuar.

17. Lidhur me këtë kërkesë, KAS-i konstaton se grupimi “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha ka qenë subjekt themelues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, sikurse rezulton nga marrëveshja për krijimin e koalicionit e datës 15.03.2023. Gjithashtu KAS-i konstaton, se me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023, Komisioneri e ka përjashtuar nga koalicioni “Bashkë fitojmë” subjektin “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha, duke i ndaluar de facto pjesëmarrjen në zgjedhje. Ligjërisht deputeti Sali Berisha dhe grupimi i tij politik nuk janë pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për pasojë deputeti Sali Berisha nuk mund të jetë ligjërisht drejtues i tij. I pyetur nga KAS-i, përfaqësuesi i palës së interesuar nuk dha asnjë të dhënë për ndonjë lidhje/raport juridik të deputetit Berisha me koalicionin ose me ndonjërin nga partitë pjesëmarrëse të tij, me të cilin të mund të justifikonte ligjërisht kërkesën e paraqitur.

18. Sipas marrëveshjes së koalicionit “Bashkë Fitojmë” të datës 15.03.2023, partia udhëheqëse e tij është Partia e Lirisë. “Parti udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor, është Partia e Lirisë” thuhet në këtë marrëveshje. Kjo do

të thotë se palët e marrëveshjes kanë pranuar me vullnet të lirë, në momentin e krijimit të koalicionit, se për zbatimin e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhet të njohë dhe pranojë Partinë e Lirisë dhe kryetarin e saj, z. Ilir Metaj si përfaqësuesit zyrtarë të koalicionit. Në pajtim me jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor (vendimi nr. 5, datë 04.04.2021), kryetari i partisë që kërkon pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor, nuk mund të jetë kush tjetër, përveç kryetarit të Partisë së Lirisë.

19. Përfundimisht KAS-i çmon se vendimet e Komisionerit nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023, me të cilat është miratuar përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë dhe për këshillat bashkiakë të 60 bashkive të tjera, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 11 të K.Pr.Administrative që parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, si dhe me pikën 3 të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, sa i takon mospasqyrimin të emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse përbri emrit të koalicionit. Për këtë arsye këto vendime duhet të ndryshohen. Në fletët e votimit, sipas shtojcave bashkëlidhur vendimit, përbri emrit të subjektit zgjedhor “BASHKË FITOJMË”, përpara shkronjave nistore BF, të shkruhet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit ILIR METAJ, si dhe përbri emrit të subjektit zgjedhor “ALEANCA LIBERALE E DJATHTË”, përpara shkronjave nistore ALD, të shkruhet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit ARTUR ROSHI.

13. Subjekti zgjedhor, koalicioni “BASHKË FITOJMË”, pasi është njohur me vendimin e K.A.S, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.³

14. Pala paditëse, subjekti “BASHKË FITOJMË” në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, pretendoi se:

- Pala e paditur KAS me vendimarrjen e tij ka gabuar duke keqinterpretuar ligjin, përkatësisht dispozitat e neneve 64, 65, 66, 98 e vijues të Kodit Zgjedhor. KAS nuk duhej të kishte legjituar aspak subjektin PD për të ngritur në themel këto pretendime të tyre lidhur me fletën e votimit, për sa kohe subjekti PD nuk provon në asnjë çast ndonjë cenim të interesave të tyre të ligjshme lidhur me paraqitjen e emrit apo përshkrimin e një apo disa subjekteve të tjera zgjedhore.
- Parë edhe nga këndvështrimi i nenit 66 të Kodit Zgjedhor, nga përmbajtja e fletës së votimit propozuar dhe miratuar nga KSHZ, nuk rezulton asnjë konfondim i mundshëm apo qoftë edhe potencial për zgjedhësit. Zgjedhësit e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” e kanë fare të qartë se kush e drejton atë koalicion dhe kush janë anëtarët përbërës të tij, apo se kush janë kandidatët e këtij koalicioni.
- Është e pakuptimtë se si mund të legjitimohet subjekti PD për të kërkuar që subjektet e tjera zgjedhore të kenë me “detyrim” ose “përcaktim” një emër “kryetari” apo “drejtuesi” të koalicionit të tyre, kur vetë koalicioni në mbledhjen e datës 15.04.2023 në KSHZ nuk arriti dot konsensusin e anëtarëve të tij për të propozuar një emër dhe

³ Kjo padi ka të bashkëlidhur edhe këto materiale: *Vendimi i nr. 361 i KSHZ “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” ; Vendimi nr. 362 i KSHZ “Vendim për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiakë në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” ; Vendimi i KAS datë 19.04.2023 objekt padie (shkurtim vendimi); Kopje e shkresës nr. prot. 367, datë 19.04.2023 drejtuar KQZ nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” lidhur me emrin që duhet të figurojë në fletën e votimit.*

rrjedhimisht në fletën e votimit u la bosh kjo pjesë. Subjekti PD nuk ka asnjë "interes të ligjshëm" në kuptim të Kodit Zgjedhor, kundrejt regjistrimit të koalicionit "Bashkë Fitojmë", në fletën e votimit me apo pa emër "kryetari" apo "drejtuesi". Nëse dikush kishte interes të ligjshëm për të kundërshtuar vendimarrjen e KSHZ, ishte vetëm koalicioni "Bashkë Fitojmë" dhe askush tjetër.

- KAS-i, në kundërshtim me çdo normë dhe praktikë ligjore, legjitimoi në proces ankimor subjektin PD, i cili pretendonte se po vepronte në emër të ligjshmërisë dhe interesit të përgjithshëm, por pa vërtetuar apo provuar në asnjë moment në mënyrë të pakundërshtueshme interesin e atij subjekti në veçanti.
- Nga ana tjetër, KAS ka kryer shkelje ligjore edhe në thelb, sepse nenin 98, pikën 3 të tij e ka keqinterpretuar me qëllim atë. Neni 98 përcakton rregullat e përmbajtjes së fletës së votimit. Kodi Zgjedhor duhet interpretuar në mënyrë strikte në rastin e fletës së votimit, dhe ligjvënësi ka patur për qëllim që detyrimi për vendosjen e emrit të kryetarit të partisë të jetë vetëm për partitë dhe jo për koalicionet. Një koalicion pa definition është i përbërë nga 2 apo më shumë parti politike, ndaj Kodi Zgjedhor nuk e ka shprehur me formë detyruese vendosjen e emrit të dikujt përbri emrit të vetë koalicionit. Pra, Kodi ka përjashtuar edhe alternativën e vendosjes me detyrim të emrit të partisë kryesuese, por ka përjashtuar nga detyrimi edhe alternativën e mundshme, të vendosjes së emrave të të gjithë kryetarëve pjesë e atij koalicioni. Duke mos përcaktuar shprehimisht këtë detyrim ligjor për koalicionet, Kodi i ka lënë hapësire ligjore vetë koalicionit që këtë çështje ta zgjidhe me marrëveshje midis anëtarëve të tij.
- Për sa kohë në marrëveshjen e partive politike pjesë e Koalicioni "Bashkë Fitojmë" nuk ishte përcaktuar nëse do të kishte një emër individ që do të figuronte tek fleta e votimit, dhe as cili ishte ky emër, vetëm koalicioni "Bashkë Fitojmë" mund të kërkonte shtimin apo ndryshimin e një emri individ përbri emrit të koalicionit. Dhe përpara seancës së datës 19.04.2023 në KAS nga ana e Koalicionit "Bashkë Fitojmë", u depozitua zyrtarisht shkresa nga përfaqësuesi i saj i autorizuar z. Endrit Braimllari, ku kërkohej në thelb që përbri emrit të koalicionit të pasqyrohej emri i z. Sali Berisha, si shprehje e vullnetit të lirë të vetë subjektit politik në këtë rast, kërkesë e cila nuk u pranua nga ana e KAS.
- Nëse vendosja e emrit të individit krahas emrit të koalicionit, do të ishte detyrim i përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, vetë KQZ (pse jo KAS apo edhe Kolegj Zgjedhor), nuk do pranonte që të regjistrohej në zgjedhje një koalicion të caktuar, pa sjellë ky i fundit në marrëveshje emrin e individit që do të figuronte në fletën e votimit të subjektit. Në rastin konkret të Koalicionit "Bashkë Fitojmë", si KQZ, ashtu edhe KAS por edhe vetë Kolegji Zgjedhor pati mundësinë që të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e këtij koalicioni. Nëse do të kishte ndonjë "mangësi" nga detyrimet ligjore të përcaktuara në mënyrë shteruese nga Kodi Zgjedhor marrëveshja e koalicionit, KQZ nga njëra anë nuk do e kishte regjistruar koalicionin, por edhe Kolegji Zgjedhor mund t'a kishte ngritur këtë pretendim kryesisht.
- Fakti se koalicioni "Bashkë Fitojmë" u regjistrua rregullisht në zgjedhjet e 14-majit, dëshmon se çdo dokument e kishte në përputhje me ligjin. Kjo tregon se nuk është detyrim ligjor i përcaktuar në Kod dhënia e një emri individ i cili do të duhej të vendosej në fletën e votimit. Rrjedhimisht, interpretimi i saktë i nenit 98, pika 3 e Kodit

Zgjedhor, lidhur edhe me nenin 65 të tij, duhet të interpretohet nga Kolegji si një e drejtë që i përket koalicionit dhe vetëm koalicionit, dhe jo si një detyrim. Po të ishte detyrim, koalicioni në rastin konkret nuk duhet të ishte regjistruar pa sjellë paraprakisht një emër të tillë që do të figuronte në fletën e votimit.

- Në rastin konkret, duke qenë një “e drejtë”, vullneti i shprehur qartë i koalicionit “Bashkë Fitojmë” nëpërmjet shkresës datë 19.04.2023 të z. Braimllari, ishte se zoti Sali Berisha duhej të figuronte në fletën e votimit, përbri emrit të koalicionit ‘Bashkë Fitojmë’.

15. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit prapësoi se:

- Referuar pretendimit të parë të paditësit se KAS nuk duhej të kishte legjitimuar subjektin PD për të ngritur në themel pretendimet e tij, pasi ky subjekt nuk ka asnjë interes të ligjshëm në ngritjen e ankimit, KAS çmon se duke qenë se çështja objekt shqyrtimi ka të bëjë me konfigurimin e fletës së votimit, si një nga subjektet zgjedhore konkurrese në zgjedhje, justifikohet interesi i ligjshëm i "Partisë Demokratike" për të paraqitur kërkesën ankimore. Gjithashtu, edhe jurisprudenca e mëparshme në shqyrtimin e ankesave nga KAS, lidhur me kompozimin e fletës së votimit, i njeh të drejtën subjekteve zgjedhore që garojnë në zgjedhje dhe rrjedhimisht do jenë pjesë e fletës së votimit, të vënë në lëvizje KAS.
- Referuar pretendimit tjetër të paditësit për keqinterpretim të nenit 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor, pala e paditur sqaron se: Pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor përcakton se *"emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi"*. Fjalja e dytë është e vlefshme si për partitë politike që garojnë më vete, ashtu dhe për koalicionet zgjedhore. Në vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e ka sqaruar në mënyrë ezauruese këtë dileme, kur në pikën 27 të vendimit ka theksuar se *"Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore"*.
- Lidhur me pretendimin tjetër të paditësit për të vendosur emrin e deputetit Sali Berisha përbri emrit të koalicionit në fletën e votimit, KAS është shprehur se duke marrë parasysh faktin që me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, grupimi "Partia Demokratike" me Kryetar z. Sali Berisha, nuk është regjistruar si pjesë përbërëse e koalicionit "Bashkë Fitojmë", rrjedhimisht deputeti Sali Berisha nuk është pjesë e këtij koalicionit dhe nuk ka se si të jetë drejtues i koalicionit.
- Në konkluzion, duke marrë parasysh marrëveshjen e koalicionit "Bashkë Fitojmë" të datës 15.03.2023, partia udhëheqëse e tij rezulton të jetë Partia e Lirisë, siç është shprehur nga vetë partitë pjesëmarrëse të koalicionit me vullnetin e tyre të plotë. Kjo do të thotë se palët e marrëveshjes kanë pranuar me vullnet të lirë, në momentin e krijimit të koalicionit, se për zbatimin e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhet të njohë dhe pranojë Partinë e Lirisë dhe kryetarin e saj, z. Ilir Metaj si përfaqësuesit

zyrtarë të koalicionit. Në pajtim me jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor (*vendimi nr. 5, datë 04.04.2021*), kryetari i partisë që kërkon pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor, duhet të jetë kryetari i Partisë së Lirisë.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

16. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë të paraqitur nga subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, vlerëson se padia duhet të rrëzohet, si e pa mbështetur në ligj dhe në prova.

17. Sikurse rezultoi nga administrimi i provave, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që do të zhvillohen më datë 14 Maj 2023. Për regjistrimin e këtij Koalicioni si subjekt zgjedhor, në zbatim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, është depozituar si dokument i domosdoshëm edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit zgjedhor, e lidhur ndërmjet partive pjesëmarrëse në koalicion. Referuar marrëveshjes së koalicionit “Bashkë Fitojmë” të administruar në cilësinë e provës, rezulton se në zbatim të nenit 65 të K.Zgjedhor, partitë pjesëmarrëse në koalicion, kanë zgjedhur si parti udhëheqëse të koalicionit, Partinë e Lirisë me kryetar të saj, z. Ilir Metaj.

18. Nga ana tjetër, edhe personi i interesuar në këtë proces gjyqësor, Partia Demokratike e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pushtetit vendor që do të zhvillohen më datë 14 Maj 2023. Ky i fundit ka ankimuar në KAS vendimin nr. 361, datë 15.04.2023 nr. 361, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “*Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*” si dhe vendimin nr. 62, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “*Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*”. Nëpërmjet kësaj kërkesë ankimore, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka kërkuar ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit, duke vendosur ndër të tjera edhe emrin e Kryetarit të partisë udhëheqëse, krahas emrit dhe shkronjave nistore të koalicioneve, si një nga kërkesat e përcaktuara në nenin 98 pika 3 e Kodit Zgjedhor.

19. Ky kërkim i subjektit zgjedhor është pranuar nga KAS, duke u vendosur që në fletën e votimit për kandidatët për Këshillin Bashkiak”, të vendoset emri i Kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicioneve, krahas emërtimit, siglës dhe shkronjave nistore të tyre.

20. Në padinë e paraqitur, pala paditëse ka parashtruar si argument fillestar për pranimin e saj, faktin se Partia Demokratike e Shqipërisë nuk duhet të legjitimohej në procedurën administrative. Sipas palës paditëse, për sa kohë subjekti PD nuk provon në asnjë çast ndonjë cenim të interesave të tyre të ligjshme lidhur me paraqitjen e emrit apo përshkrimin e një apo disa subjekteve të tjera zgjedhore, si dhe nuk rezulton asnjë konfondim i mundshëm apo qoftë edhe potencial për zgjedhësit, KAS nuk duhet të kishte marrë në shqyrtim në themel pretendimet e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

21. Në lidhje me pretendimin për mungesën e legjitimitimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, për të paraqitur ankim në lidhje me elementët që lidhen me përmbajtjen e fletës së votimit, Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk është i bazuar në ligj. Në rastin objekt gjykimi,

pretendimet e palës paditëse, si dhe personit të interesuar bazohen në qëndrimet e tyre sa i takon përmbajtjes së fletës së votimit. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, elementët e fletës së votimit lidhen me orientimin e drejtë të zgjedhësve sa i takon subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje dhe qartësinë e të dhënave identifikuese të tyre, me qëllim shmangien e konfundimeve në shprehjen e vullnetit të tyre në zgjedhje. Në këtë drejtim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se konfigurimi i fletës së votimit, duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësin, si dhe të përmbajtë të gjitha elementët e kërkuara nga ligji. Përmbajta e fletës së votimit dhe disiplinimi në ligj i disa elementëve të detyrueshëm të saj, lidhet me interesin madhor që përfaqëson procesi zgjedhor në një shtet demokratik, si dhe vlerësimi sa më i drejtë i vullnetit të zgjedhësve, në ushtrimin e së drejtës së tyre themelore për të zgjedhur.

22. Bazuar në rëndësinë që ka përmbajtja e fletës së votimit në orientimin e drejtë të zgjedhësve, fakt që sjell efekte të qënësishme në rezultatin e zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor vlerëson se për kundërshtimet që lidhen me përmbajtjen e fletës së votimit, kanë interes të ligjshëm dhe për rrjedhojë, duhet të legjitimohen për të paraqitur kundërshtime të gjitha subjektet zgjedhore që janë regjistruar si pjesëmarrës në zgjedhje.

23. Në rastin konkret, pala ankuese në procedurën administrative (Partia Demokratike e Shqipërisë), është subjekt zgjedhor i regjistruar në zgjedhje. Nga ana tjetër, kjo palë ka arsyetuar qëndrimin e saj sa i takon përmbajtjes së fletës së votimit, duke theksuar nevojën e orientimit të drejtë të zgjedhësve edhe në rastet e koalicioneve zgjedhore, duke vënë theksin në konfigurimin e fletës së votimit, me të gjitha elementët e detyrueshëm të parashikuar nga Kodi Zgjedhor.

24. Bazuar në analizën e mësipërme, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se në rastin konkret, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, si subjekt zgjedhor i regjistruar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ka interes të ligjshëm për të kundërshtuar përmbajtjen e fletës së votimit. Për rrjedhojë, Kolegji Zgjedhor e vlerëson të pabazuar pretendimin e palës paditëse, sa i takon legjitimitetit subjektivit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili pas shqyrtimit në themel të ankimit të paraqitur, ka disponuar me vendimin nr. 61, datë 19.04.2023.

25. Në vijim të analizës së pretendimeve të parashtruara nga pala paditëse, sa i takon bazueshmërisë në ligj të vendimit nr.61, datë 19.04.2023 të KAS, Kolegji Zgjedhor vlerëson se vendimi i KAS është i bazuar në ligj dhe nuk ka vend për shfuqizimin e tij.

26. Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, është regjistruar si koalicion pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor. Në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit zgjedhor si subjekt zgjedhor, është depozituar pranë KQZ edhe marrëveshja e koalicionit, në të cilën është përcaktuar Partia e Lirisë, si parti udhëheqëse e koalicionit. Në kuptim të nenit 65 pika 3 të K.Zgjedhor, sipas të cilit: “*Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit*”, Partia e Lirisë, duhet të ushtrojë gjitha të drejtat dhe detyrimet që parashikohen nga Kodi Zgjedhor për subjektet zgjedhore.

27. Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme në mënyrë sistematike edhe me

dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor vlerëson se koalicioni si subjekt zgjedhor, ka të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse edhe subjektet e tjera zgjedhore. Në rastin e koalicionit, vetë ligji ka parashikuar detyrimin e përcaktimit të partisë udhëheqëse të koalicionit, e cila ushtron të gjitha të drejtat dhe merr përsipër detyrimet që burojnë nga dispozitat e Kodit Zgjedhor

28. Në rastin konkret, ka rezultuar se partitë pjesëmarrëse në Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, në marrëveshjen e koalicionit kanë përmbushur detyrimin ligjor që buron nga neni 65 pika 3 e K.Zgjedhor, duke zgjedhur si parti udhëheqëse të koalicionit, Partinë e Lirisë, me kryetar z. Ilir Metaj. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor vlerëson pas regjistrimit të koalicionit, raporti juridik i këtij këtij të fundit në kuadër të procesit zgjedhor, do të disiplinohet nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe në zbatim të këtij Kodi, është partia udhëheqëse ajo që ushtron të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky ligj.

29. Kolegji Zgjedhor vlerëson të theksojë se në rastin e koalicioneve zgjedhore, duhet të bëhet diferencim ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me procesin zgjedhor dhe të drejtave dhe detyrimeve reciproke të rregulluara me marrëveshje ndërmjet partive politike që marrin pjesë në koalicion zgjedhor. Pavarësisht mënyrës se si partitë politike në një koalicion kanë rregulluar detyrimet reciproke ndërmjet tyre, sa i takon angazhimit dhe shpërndarjes së përfaqësisë në rastin e arritjes së rezultateve pozitive në zgjedhje, në kuadër të procesit zgjedhor kanë detyrimin që të zbatohen me përpikmëri të gjitha detyrimet që burojnë nga Kodi Zgjedhor. Koalicioni si subjekt zgjedhor merr pjesë në zgjedhje në mënyrë të barabartë me të gjitha subjektet e tjera zgjedhore, dhe për rrjedhojë do të nënshtrohet të njëjtit regjim juridik që disiplinon fazat e ndryshme të procesit zgjedhor.

30. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor vlerëson se elementët përmbajtësorë të fletës së votimit, për vetë rëndësinë që kanë në orientimin e drejtë të zgjedhësve, janë disiplinuar në nenin 98 të Kodit Zgjedhor. Në pikën 3 të kësaj dispozite ligjore parashikohet në mënyrë të shprehur se: *“Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. **Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë.** Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi”*. Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se në këtë dispozitë ligjore janë përcaktuar në mënyrë të shprehur elementët e detyrueshëm që duhet të përmbajë fleta e votimit, duke specifikuar që përbri emrit të subjektit duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Këto komponentë të rëndësishëm për identifikimin e subjekteve zgjedhore, janë të detyrueshëm jo vetëm për partitë politike por edhe për koalicionet si subjekte zgjedhore. Ky është një qëndrim i konsoliduar në Kolegjin Zgjedhor, i cili në vendimin nr. 6, datë 04.04.2021 ka mbajtur qëndrimin se: *“Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore. Pra, fleta e votimit do përmbajë ndër të tjera dhe logon që përfaqëson koalicionin në zgjedhje”*.

31. Në rastin konkret, rezulton se subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka zgjedhur partinë udhëheqëse dhe si e tillë, është kjo e fundit që ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet për efekt të zbatimit të Kodit Zgjedhor. Kolegji vlerëson se përfshirja në fletën e

votimit të elementëve identifikues (emri, sigla dhe kryetari i partisë), janë elementë të detyrueshëm që parashikohen nga ligji dhe si të tilla, duhet të përmbushen nga partia udhëheqëse që në rastin konkret është Partia e Lirisë, me kryetar z. Ilir Metaj.

32. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor e gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse, sipas të cilës, shënimi në fletën e votimit të emrit të kryetarit të partisë, është një detyrim që buron vetëm për partitë politike dhe jo për koalicionet. Sikurse është analizuar edhe më sipër, Kolegji vlerëson se përmbajtja e fletës së votimit, ka rëndësi thelbësore për orientimin e zgjedhësve dhe si e tillë, është normuar në mënyrë të qartë nga ligji, duke mos i lënë hapësirë vlerësimi subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje. Në këtë drejtim, komponentët e detyrueshëm që përmban fleta e votimit janë të zbatueshëm për të gjitha subjektet zgjedhore, përfshi këtu edhe koalicionet zgjedhore, të cilat në momentin e regjistrimit si subjekte zgjedhore, kanë detyrimin të zgjedhin edhe partinë udhëheqëse të koalicionit, që ushtron të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky ligj. Nëse do të pranohej fakti se për koalicionet zgjedhore nuk gjen zbatim fjalja e dytë e pikës 3 të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, atëherë në interpretim *a contrario*, do të pranohej se lidhje me këto të fundit si subjekte zgjedhore, nuk duhet të kishte asnjë element identifikues, përveçse emrit të koalicionit. Ky përfundim, vjen në kundërshtim me frymën dhe parimet mbi të cilat mbështetet Kodi Zgjedhor, duke cënuar mbi të gjitha barazinë e subjekteve zgjedhore. Në këto kushte, në interpretim sistematik të nenit 63 dhe 93 të K.Zgjedhor, Kolegji vlerëson se parashikimi ligjor për shënimin e emrit të kryetarit të partisë në fletën e votimit, gjen zbatim edhe për koalicionet, duke u shënuar emri i kryetarit të partisë udhëheqëse, e cila për efekt të ligjit zgjedhor ushtron të drejtat dhe detyrimet e Koalicionit.

33. Gjithashtu, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse, sipas të cilës, zgjedhja e drejtuesit të koalicionit, është e drejtë e këtij të fundit dhe në ushtrim të kësaj të drejtë, tre partitë pjesëmarrëse në koalicion, kanë zgjedhur si drejtues të koalicionit z. Sali Berisha. Në mbështetje të këtij pretendimi, pala paditëse ka paraqitur edhe shkresën nr. 143 prot., datë 15.03.2023 “Marrëveshje”, në të cilën është formalizuar vullnetin si më sipër.

34. Kolegji zgjedhor vlerëson se regjistrimi i një koalicioni në zgjedhje, është i kushtëzuar nga respektimi i dispozitave ligjore që dispijlojnë procesin zgjedhor. Vullneti i partive pjesëmarrëse në një koalicion, sjell efekte në procesin zgjedhor, sa kohë që nuk cenon këto dispozita ligjore. Sikurse është analizuar edhe më sipër, regjistrimi i një koalicioni si subjekt zgjedhor, sjell lindjen e disa të drejtave dhe detyrimeve për të, të cilat dispijlohen nga Kodi Zgjedhor. Ky i fundit ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe detyruese për regjistrimin e koalicionit edhe zgjedhjen e një partie udhëheqëse, e cila ushtron të drejtat dhe detyrimet për efekt të ligjit. Të drejtat dhe detyrimet e koalicionit lindin në momentin e regjistrimit të koalicionit në zgjedhje dhe partia udhëheqëse është përfaqësuese e koalicionit në çdo raport juridik të krijuar për efekt të procesit zgjedhor. Në këto kushte, asnjë marrëveshje ndërmjet partive politike pjesëmarrëse në koalicion, e lidhur pas regjistrimit të koalicionit në zgjedhje, nuk mund të sjellë pasoja juridike në kuadër të procesit zgjedhor, në kundërshtim me rregullimet e Kodit Zgjedhor, përfshi këtu edhe pasqyrimin e elementëve identifikues në fletën e votimit.

35. Në këtë drejtim, Kolegji e gjen të pabazuar edhe argumentin e palës paditëse sipas të cilës, në momentin e regjistrimit nuk ka qënë detyrim përcaktimi i emrit të drejtuesit të

koalicionit për të vendosur në fletën e votimit, pasi ndryshe KSHZ do të kishte refuzuar regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” në zgjedhje. Kolegji vlerëson se ligji ka parashikuar në mënyrë të qartë si kusht për regjistrimin e koalicionit, përcaktimin e partisë udhëheqëse, parti e cila është përcaktuar qartë në marrëveshjen e koalicionit dhe nuk ka pasur pengesë ligjore për regjistrimin e tij në zgjedhje. Ndërkohë që elementët e fletës së votimit, janë komponentë që rrjedhin nga pasojat juridike që vetë ligji i ka njohur regjistrimit të partisë udhëheqëse të koalicionit, të përcaktuar në marrëveshjen e depozituar në momentin e regjistrimit. Të drejtat dhe detyrimet e partisë udhëheqëse janë elementë të përcaktohen në ligjin zgjedhor dhe nuk i atribuohen vullnetit të partive pjesëmarrëse në koalicion. Këto të fundit kanë të drejtë të zgjedhin partinë udhëheqëse, por jo të determinojnë më pas edhe të drejtat dhe detyrimet që ushtrohen nga kjo parti, për efekt të zbatimit të ligjit zgjedhor, pasi është ky i fundit që i ka përcaktuar ato në mënyrë të shprehur.

36. Procesi zgjedhor, për vetë rëndësinë që ka në një shtet demokratik, disiplinohet nga dispozitat e Kodit Zgjedhor. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë të barabartë dhe demokratike, por njëkohësisht kanë detyrimin të respektojnë kornizën ligjore që disiplinon procesin zgjedhor. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të qartë përmbajtjen e fletës së votimit, elementë të cilat janë të zbatueshme për të gjitha subjektet zgjedhore, në funksion të organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të barabarta, si dhe duke i shërbyer thelbësisht qartësisë së zgjedhësve.

37. Si përfundim, Kolegji Zgjedhor vlerëson se vendimi nr. 61, datë 19.04.2023 i KAS, është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë, padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi.

U shpall në Tiranë, më datë 21.04.2023.

GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE GJYQTARE
Alma KOLGJOKA Emona MUÇI Manjola XHAXHO Esmeralda XHILI Marsela DERVISHI